



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:171521

Datë: 19.04.2024

Numri i dokumentit: 05596245

KPPP.nr.498/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen përmbartimore të kreditorit “MAMS” SH.P.K., me NUI: 810104414, me seli në rr. “Hamdi Berisha” Nr. 9, në Gjilan, kundër debitorit N.P.T. “Florenti” - “K.B.” B.I., me NUI: 811305334, me seli në rr. “Shemsi Ahmeti”, në Mitrovicë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.207/21 të datës 10.06.2021, të Përmbartuesit Privat Kushtrim Musa, me seli në Gjilan, jashtë seancës, me datë 19.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit N.P.T. “Florenti” - “K.B.” B.I., i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.207/21 i datës 10.06.2021, i Përmbartuesit Privat Kushtrim Musa.
- II. MBETET NË FUQI Urdhri Përmbartimor P.nr.207/21 i datës 10.06.2021, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Kushtrim Musa.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr.207/21 të datës 10.06.2021, me të cilin ka lejuar përmbartimin, në bazë të dokumentit të besueshëm - Faturës Nr. 706001004 të datës 06.07.2020; Faturës Nr. 720001007 të datës 20.07.2020; Faturës Nr. 810001011 të datës 10.08.2020; Faturës Nr. 810001012 të datës 10.08.2020; Faturës Nr. 907001011 të datës 07.09.2020; Faturës Nr. 907001012 të datës 07.09.2020; Faturës Nr. 916001014 të datës 16.09.2020; Faturës Nr. 921001012 të datës 21.09.2020; Faturës Nr. 1005001002 të datës 05.10.2020; Faturës Nr. 1026001009 të datës

26.10.2020; Faturës Nr. 1026001010 të datës 26.10.2020; Faturës Nr. 1110001022 të datës 10.11.2020; Faturës Nr. 1110001023 të datës 10.11.2020; Faturës Nr. 1130001004 të datës 30.11.2020; Faturës Nr. 1214001005 të datës 14.12.2020; Faturës Nr. 1221001004 të datës 21.12.2020; Faturës Nr. 1221001006 të datës 21.12.2020; Faturës Nr. 118001006 të datës 18.01.2021; Faturës Nr. 118001007 të datës 18.01.2021; Faturës Nr. 215001006 të datës 15.02.2021; Faturës Nr. 215001009 të datës 15.05.2021; Faturës Nr. 301001012 të datës 01.03.2021; Faturës Nr. 301001013 të datës 01.03.2021; Faturës Nr. 315001006 të datës 15.03.2021; Faturës Nr. 329001008 të datës 29.03.2021; Faturës Nr. 329001009 të datës 29.03.2021; Faturës Nr. 412001011 të datës 12.04.2021 dhe Faturës Nr. 412001012 të datës 12.04.2021, duke detyruar debitorin që në emër të borxhit të pa paguar sipas faturave të lartcekura t'ia paguajë kreditorit shumën e përgjithshme prej 5,442.75 € (pesëmijë e katërqind e katërdhjetë e dy euro e shtatëdhjetë e pesë), si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore, me ndalimin e mjeteve monetare në para të cilat debitori i ka në llogaritë bankare në të gjitha bankat komerciale në Kosovë dhe bartjen e shumës përkatëse të përbaruesit privat Kushtrim Musa, pastaj të barten në llogarinë e kreditorit, ose përmes regjistrimit, sekuestrimit, vlerësimit dhe shitjes së sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit, ashtuqë të paguhet borxhi i kërkuar nga kreditori.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar në tërësi urdhrin përbarimor, duke deklaruar ndër të tjerash se palët kanë lidhur marrëveshje bashkëpunimi në cilësinë e operatorëve ekonomik, sipas të cilës kreditori ka marrë përsipër që në baza të rregullta ta furnizoj debitorin me produkte të ndryshme, ndërsa debitori të bëjë pagesën e tyre dhe se në çdo fund vit apo fillimin e vitit të ardhshëm kalendarik të bëjë barazimin në koordinim të përbashkët për konfirmimin e obligimeve financiare. Më tutje ka theksuar se në rastin konkret faturat nuk janë të përshtatshme për përbarim, sepse koha e përmbushjes së detyrimit është e lidhur ngushtë me barazimin e obligimeve financiare dhe se debitori vetëm pas konfirmimit të obligimeve të ndërsjella do t'i përmbush të gjitha obligimet financiare. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorit si i bazuar, të prishet urdhri për lejimin e përbarimit dhe të abrogohen të gjitha veprimet juridike.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar në tërësi prapësimin e debitorit duke deklaruar se procedura përbarimore është inicuar në bazë të faturave që plotësojnë kushtet ligjore, të cilat janë origjinale dhe të nënshkruara si dhe nuk kanë pasur asnjë vërejtje nga ana e debitorit, për shkak se nga emaili i drejtuar tek debitori me datën

07.04.2021 dhe 13.04.2021, kreditori nuk ka pranuar asnjë përgjigje nga ana e tyre, ndërsa përmes telefonit është përgjigjur dhe ka pohuar se do ta realizonte pagesën. Gjykatës i ka propozuar që të refuzohet prapësimi i debitorit, dhe të vërtetohet si i bazuar urdhri për lejimin e përmbarimit.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore (tutje LPP), gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat në bazë të së cilave është lejuar urdhri për përmbarim, i plotësojnë kushtet për të qenë dokumente të besueshme dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara, në përputhje me nenin 29 dhe 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “*, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, dhe sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm, sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Në rastin konkret gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbaruesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm - Faturën Nr. 706001004 të datës 06.07.2020; Faturën Nr. 720001007 të datës 20.07.2020; Faturën Nr. 810001011 të datës 10.08.2020; Faturën Nr. 810001012 të datës 10.08.2020; Faturën Nr. 907001011 të datës 07.09.2020; Faturën Nr. 907001012 të datës 07.09.2020; Faturën Nr. 916001014 të datës 16.09.2020; Faturën Nr. 921001012 të datës 21.09.2020; Faturën Nr. 1005001002 të datës 05.10.2020; Faturën Nr. 1026001009 të datës 26.10.2020; Faturën Nr. 1026001010 të datës 26.10.2020; Faturën Nr. 1110001022 të datës 10.11.2020; Faturën Nr. 1110001023 të datës 10.11.2020; Faturën Nr. 1130001004 të datës 30.11.2020; Faturën Nr. 1214001005 të datës 14.12.2020; Faturën Nr.

1221001004 të datës 21.12.2020; Faturën Nr. 1221001006 të datës 21.12.2020; Faturën Nr. 118001006 të datës 18.01.2021; Faturën Nr. 118001007 të datës 18.01.2021; Faturën Nr. 215001006 të datës 15.02.2021; Faturën Nr. 215001009 të datës 15.05.2021; Faturën Nr. 301001012 të datës 01.03.2021; Faturën Nr. 301001013 të datës 01.03.2021; Faturën Nr. 315001006 të datës 15.03.2021; Faturën Nr. 329001008 të datës 29.03.2021; Faturën Nr. 329001009 të datës 29.03.2021; Faturën Nr. 412001011 të datës 12.04.2021 dhe Faturën Nr. 412001012 të datës 12.04.2021, të cilat fatura i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në këto fatura janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturave, është përcaktuar shuma e cila përbën detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, si dhe të njëjtat janë pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt.

Gjykata vlerësoi pretendimet e debitorit se në faturën e kreditorit nuk është treguar koha e përmbushjes së detyrimit monetar dhe gjeti se e njëjta nuk gjen mbështetje ligjore, sepse në rastin konkret faturat e lartcekura i plotësojnë kushtet e përcaktuara për zbatimin e përmbartimit në bazë të dokumentit të besueshëm për faktin se afati i përmbushjes së detyrimit është përcaktuar në secilën nga faturat si dhe të njëjtat janë bërë të arritshme për pagesë.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet tjera të debitorit, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk mund të jenë objekt shqyrtimi i procedurës përmbartimore prandaj dhe nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të formalitetit rigoroz, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbartimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit objekt i përmbartimit.

Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se në rastin konkret këto fatura i plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP, për zbatimin e përmbartimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që të njëjtat janë dorëzuar në origjinal, mbajnë vulën dhe nënshkrimin e pranimit të debitorit, si dhe nuk janë kontestuar asnjëherë nga debitori.

Andaj, bazuar në të lartcekurat, gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbartimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.498/24, datë 19.04.2024

Gjyqtari

Hasan Kryeziu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.